REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr 642/12 Prot.

Pogradec, më 26.02.2024

**VENDIM**

**NR. 10, DATË 23.02.2024**

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25.01.2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 25.01.2024, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 25.01.2024 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARE E KËSHILLIT**

**Miranda OLLDASHI**

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2024**

ORA : 12 : 00

JANË PREZENT 24 KËSHILLTARËPROTOKOLLI I MBLEDHJSES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 25.01.2024 ME KËTË REND DITE.

1. Projekt – Vendim : Miratimi i Rendit të ditës.

2. Projekt – Vendim: Miratimi i Procesverbalit të datës 28.12.2023.

3. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.12.2023.
4. Projekt-Vendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për periudhën Dhjetor 2023.
5. Projekt-Vendim:Për miratimin e kriterve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2024.
6. Projekt-Vendim:Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.105,datë 02.12.2021, Për miratimin e rregullores "Per shfrytëzimin e happësirave publike" dhe " Harta që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore."
7. Projekt-Vendim:Për ngritjen e komisionit keshillimor për dhënien e titujve vendore të nderit
8. Projekt-Vendim:Për dhënien e ndihmës financiare z.Mirjan Buzo për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
9. Projekt-Vendim:Për dhënien e ndihmës financiare z.Neki Hamzallari për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
10. Projekt-Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare z.Hamdi Alinj për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
11. Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe prezantimi në mediat lokale .
12. Kërkesa,Ankesa;
-Kërkesë nga banorët e ish-Hoteli Guri i Kuq për privatizimin e banesave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... BASHKIA ...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Nr.______prot. Pogradec më, ___.___.2024

**LËNDA**: **Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec**

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Ejnte më datë 25.01.2024,ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec,zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë,e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015,neni 53 pika 4,dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40 datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Procesverbalit të datës 28.12.2023.
3. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.12.2023.
4. **Projekt-Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për periudhën Dhjetor 2023.
5. **Projekt-Vendim:**Për miratimin e kriterve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2024.
6. **Projekt-Vendim:**Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.105,datë 02.12.2021, Për miratimin e rregullores "Per shfrytëzimin e happësirave publike" dhe " Harta që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore."
7. **Projekt-Vendim:**Për ngritjen e komisionit keshillimor për dhënien e titujve vendore të nderit
8. **Projekt-Vendim:**Për dhënien e ndihmës financiare z.Mirjan Buzo për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
9. **Projekt-Vendim:**Për dhënien e ndihmës financiare z.Neki Hamzallari për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
10. **Projekt-Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare z.Hamdi Alinj për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

11.**Projekt-Vendim shtese**

**Miratimi i Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 -2027 dhe të Buxhetit Vjetor 2024 të Bashkisë Pogradec.**

12.Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe prezantimi në mediat lokale .

13. **Peticioni i Kopshtit Liri Como**

14.**Kërkesa,Ankesa;**

-Kërkesë nga banorët e ish-Hoteli Guri i Kuq për privatizimin e banesave

-Kerkese nga z Rafet Cake nga fshati Gurras i cili pretendon se ngjitur me gardhin e tij janë vendosur plepa nga z.Shuli

**SEKRETARE E KËSHILLIT**
**Jona BOJKO**

**Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si më poshtë:**
**Komisioni** I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes se Mire, Administrates,Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikes, Konflitit te Interesit, Standarteve dhe Apelimeve.**Komisioni** I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik te Bashkise,Mbikeqyrjes Financiare,I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural, Emertimeve.". **Komisioni** I Sherbimeve Publike, Transportit, Levizshemrise Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacioit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapesinor, Infrastruktures dhe Strehimit .**Komisioni** I Sigurise Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, I Qeverise Elektronike dhe Teknologjise se Informacionit, **Komisioni** I Arsimit , Sporteve dhe Clodhje, I Kultures, Trashegimise Kulturore, Dhenies se Titujve dhe Emertimeve, , ditën e ,Mërkurë data 24.01.2024, ora : **12:00** për pikat **1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12 ,te** rendit të ditës,në Sallën e Këshillit Bashkiak.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2024

**1.Projekt – vendim :**Miratimi I Rendit të ditës.

Diskutime

M. Karnolli: Përshëndetje të dashur kolegë! Jemi sot në mbledhjen e radhës dt. 25.1.2024.
Materialet i kemi marrë me email dhe fizikisht po ashtu.
Unë do të shtoja edhe ~~pikën nr~~ përfshinin të cilin nuk e kemi vendosur akoma. U zhvilluan takime me drejtoreshat e kopshtit edhe të çerdhes, po ashtu edhe me prindërit andaj tani duhet të vendosim.
S. Hoxhillari: Unë do të shtoja edhe Kalendarin buxhetor afatmesëm 2025-27 dhe
dhe buxhetin vjetor 2024 të bashkisë Pogradec.
Ky projekt-vendim duhet të futet këtë mbledhje në rendin e ditës për shkak të afateve që duhen plotësuar.
M. Karnolli: Në rregull
K. Tope: Projekt-vendimi nr. 7 "Për ngritjen e Komisionit Këshillimor të dhënies së titujve të nderit, duke qenë relatuar ligji dhe nenit përkatës nuk është kompetencë (e këshillit).
Projekt-vendimi nr 6 ka një interes të gjerë publik andaj duhet të kalojë në konsultim publik. Përsa i përket relacionit të këtij pv, unë mendoj që duhet zgjeruar dhe mbledhjen tjetër ta bëjmë gati.
M. Karnolli: Atëherë je gati të hedhim në votim rendin e ditës duke përjashtuar pikën 6 dhe 7 të rendit të ditës dhe duke shtuar një projekt-vendim që titullohet: "Miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të Buxhetit vjetor 2024 të Bashkisë Pogradec.

**U votua**

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) **Jo**

Miratohet pika nr. 1 e rendit të ditës me të gjitha ndryshimet e cituara më lart.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2024**

**2. Pika nr ___** : "Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 28.12.2023 të Këshillit Bashkiak Pogradec" .

M. Kamolli: Pika nr. 2. është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.12.2023". Është një projekt-vendim rutinë. Përveç kësaj nëse e bëni para dhe firmosur, ndaj ju ftoj të kalojmë në votim pikën nr. 2 të rendit të ditës.

## U votua

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet pika nr. 2. e rendit të ditës me 24 vota pro.

**Mbledhje e KëshilBashkiak** **Pogradec më ___.___. 2024.**

**3 Pika nr** __ Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.12.2023

Diskutime

M. Kamolli: Po vazhdoj me leximin e vendimeve dhe konfirmimin e prefektit për mbledhjen e datës 28.12.2023.

**U votua**

**Pro** __________

**Kundër** __________

**Abstenim** __________

**Miratohet Po Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2024

**4.Pika nr ___:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për periudhën Dhjetor 2023.

Diskutime

A. Kamolli: Vazhdojmë me projekt-vendimin nr. 4 të rendit të ditës "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për periudhën Dhjetor 2023.
Dëgjojmë përfaqësuesin e ndihmës ekonomike

L. Kickolloni: Gjatë muajit Dhjetor 2023 do të trajtohen me ndihmë ekonomike 183 familje me fond 771322 lekë.
Nr. i familjeve nga muaji në muaj është i përafërt / i papërfillshëm

C. Hoxhilloni: Ky është një projekt-vendim rutinë për nuk ia vlen të diskutosh nëse do të miratojmë ose jo
Unë them të kalojmë në votim që të miratojmë.

M. Kamolli: Atëherë ju ftoj të kalojmë në votim pikën nr. 4 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 4. e rendit të ditës me 23 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2024

**5.Pika nr :** "Për miratimin e kriterve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2024.

Diskutime

M. Kamolli : Vazhdojmë me pikën nr. 5 të rendit të ditës.
Sot kemi për të miratuar kriteret që duhet të plotësojnë këto familje për të trajtohen me ndihmë ekonomike.
Dëgjojmë specialisten
L. Dishkollori :
Kemi sjellë sot kriteret e familjeve në nevojë për miratim përpara jush.
Janë disa kushte që duhet të plotësohen.
K. Gjoni : Nga ndaj kushtet është fakti i të pasurit shumë fëmijë. Sa shumë? Cilat familje quhen me shumë fëmijë?
L. Dishkollori : Për nr. të fëmijëve bëhet vlerësimi social-ekonomik.
L. Bertllari : Sa është raporti mes atyre që aplikojnë dhe atyre që përfitojnë, kemi një shifër? [illegible]
A. Prifti : Herë tjetër nëse do kini një raport të tillë informacion do ishte shumë mirë.
Luljeta : Ka raste kur bëhen deklarime të rreme dhe trajtimi refuzohet.

M. Kamolli : Atëherë jemi gati të hedhim në votim pikën nr. 5 të rendit të ditës.

**U votua** Gjen. F. Pikuli

**Pro** 24

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 5 e rendit të ditës me 24 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2023**

6.**Pika nr ___** : Për dhënien e ndihmës financiare z.Mirjan Buzo për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.

Diskutime

M. Kamolli: Atëherë vazhdojmë me dhënien e ndihmës financiare për z. Mirjan Buzo për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë. Fletojmë drejtorin e Emergjencave.

Besa Përshpëdetja: Në fund të seancës në kemi sjellë përpara jush tre projekt-vendime për dhënie ndihme financiare, për dëme të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë. Kemi sjellë z. Mirjan Buzo, z. Nelci Hamzallari dhe z. Hamdi Alinj. Rasti i fundit ishte i z. Alinj, nga fshati Kashnicë.

M. Kamolli: Nuk kemi nevojë të themi apo diskutojmë më shumë, ajo ishte shumë e qartë. Atëherë ti hedhim në votim këto projekt vendime.

Atëherë të hedhim në votim pikën nr. 6 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 24

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **(Po)** **Jo**

Miratohet pika nr. 6. e rendit të ditës me 24 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2023**

**9.Pika nr ___** "Për dhënien e ndihmës financiare z.Neki Hamzallari për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.".

Diskutime

M. Kamolli:

Ju ftoj të kalojmë në votim pikën nr. 7 të rendit të ditës "Për dhënien e ndihmës financiare z.Neki Hamzallari për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesë".

**U votua**

**Pro** 24

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (**Po**)

Miratohet pika nr. 7 e rendit të ditës me 24 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2023

**10.Pika nr ___ :** `` Për dhënien e ndihmës financiare z.Hamdi Alinj për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë ``.

Diskutime

M. Kamolli :

Vendosjmë në dhënien e ndihmës financiare z. Hamdi Alinj për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë

E hedhim në votim.

**U votua**

**Pro** 24

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Miratohet pika nr. 8 e rendit të ditës me 24 vota pro.

9. Pr. shtesë.

Miratimi i kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të Buxhetit vjetor 2024 të Bashkisë Pogradec.

M. Kamolli: Vazhdojmë me miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe të buxhetit vjetor 2024 të Bashkisë Pogradec.

Ftoj Z. Hexhillari, si kryetare i komisionit të ekonomisë.

S. Hexhillari: Ne e diskutuam edhe në mbledhjen e komisionit, edhe në fillim të mbledhjes së sotme kur e prezantuam që të shtonim në rendin e ditës së mbledhjes së sotme.

Sot është prezantimi i kalendarit të Programit Buxhetor, vetëm i programit, kështu që nuk kemi ç'të diskutojmë.

M. Kamolli: Atëherë ju ftoj të hedhim në votim projekt-vendimin shtesë.

pro 24

Miratohet pika nr. 9 e rendit të ditës me 24 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2024**

**11.Pika nr ___:**. Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe prezantimi në mediat lokale ..

Diskutime

A. Kamolli: Një pikë për efumi planifikuar në rendin e ditës është edhe raporti i performancës së Keshillit Bashkiak për vitin 2023.

Ftoj znj. Bajko të na e lexojë.

J. Bajko lexon raportin e performancës.

**U votua**

**Pro** __________

**Kundër** __________

**Abstenim** __________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Miratohet Po Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

## INFORMACION PER VENDIMARRJEN DHE PERFORMACEN E KESHILLIT TE BASHKISE POGRADEC PER VITIN 2023

**Tënderuar!**

Këshilli I Bashksië Pogradec për vitin 2023 ka pasur një aktivitet intensiv në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role duke u bazuar ne ligjin 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore"

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Gjate vitit 2023 jane realizuar ne total 18 mbledhje te Keshillit,12 prej tyre te radhes dhe 6 jashte radhe me kerkese te Kryetarit te Bashkise, jane realizuar 18 mbledhje komisioni. Dhe në total jane miratuar 152 vendime. Vetëm dy Vendime janë kthyer nga Prefektura.

Këtë vit të gjitha mbledhjet janë zhvilluar me takime fizike në sallën e Këshillit Bashkiak. Nga 18 mbledhje vetem dy prej tyre nuk janë transmetuar live për arsye teknike.Të gjitha mbledhjet e tjera Këshillit Bashkiak janë transmetuar live në faqen e Facebook- të Këshilit Bashkiak, cka ka bërë që komuniteti të ndjekë direct mbledhjen madje të jape dhe mendimet dhe sygjerimet e tij për vendimet dhe cështjet që janë shqyrtuar.

Gjithashtu gjatë vitit2023 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin në mënyrë që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara me nje fond prej **1,697,000 lekë.**

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Dhe për vitin 2023 sfida kryesore ishte implementimi I rregulloreve dhe planit të aktiviteteve në praktikë. Në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve ne masën 80%.

Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve këshilli është asistuar nga Projekti "Bashki të Forta" I cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur vazhdimin e implementimit të këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli I Këshillit të Bashksië.

Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2023, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetiti të realizohet nëpërmejt komunikimit kryesisht nëpërmjet takimeve fizike por edhe publikimit dhe marrjes së mëndimeve nëpërmjet rrjeteve sociale.\. Për këtë qëllim faqja e Facebbok-ut e Këshillit Baskiak Pogradec e cila u hap në vitin 2020, ka qënë active duke publikuar vazhdimisht aktivitet të këshillit , përvec transmetimit live të mbledhjeve e cila tashmë është bërë një procedurë rutinë.

Po në këtë faqe kanë erdhur shumë mendime dhe sygjerime nga komuniteti. Gjithësesi, nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashksië Pogradec dhe përcjellja e mendime ve të tyre ne mbledhjet e komisioneve dhe të këshillit.

Persa u perket konsultimeve publike në zbatim të Rregullores së Konsultimeve Publike kemi realizuar 4 (katër) Konsultime Publike :

1. -Konsultim Publik per buxhetin 2024 dhe Paketën Fiskale , ne të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec.
2. -Miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ndertim aerogjeneratore, fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasurine me sipërfaqe totale 13 ha e 2500m (trembedhjete ha e dymijë e pësëqind m) .
3. -Për dhënien e dakortësisë, për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor public të sipërfaqes pyjore prej 0.32(zero presje tridhjete e dy) ha, e ndoshur në ekonominë pyjore Bishnicë (pjesa ekonomike uji i ftohtë), për ndërtimin e hidrocentraleve "Zgallo1 & Zgallo 2 , nga shoqëria "autovision al" shpk "
4. -Për dhënien e dakortësisë, për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik të sipërfaqes pyjore prej 0.994( zero presje nëntëqind e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

nëntëdhjetë e katër)ha, e ndodhur në ekonominë pyjore Bishnicë (pjesa ekonomike tallë), për ndërtim hidrocentrali "Shpella Poshtë II", nga shoqëria"Liria energji" shpk".

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik I ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik I iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashksië. Konkretisht jane depozituar ne total 28 kerkesa drejtuar keshillit Bashkiak, katër prej te cilave duke qene se kane qene kompetencen e Keshillit eshte bere e mundur marrja e vendimeve. Kerkesat e tjera jane trajtuar dhe jane koordinuar me ekzekutivin e Bashkise dhe ne te gjitha rastet jane informuar qytetaret.Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përvec ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruar nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë project vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2023 u realizuan dhe u paraqitën në këshill informacionet dhe raportet nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë këshilli.

Në këtë drejtim, duke qënë se edhe për vitin 2023, në planin e aktiviteteve të miratuar janë planifikuar një sëre informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e mire janë edhe detyrime ligjore për tu shqyrtuar nga këshilli, do ishte e nevojshme një bashkëpunim më I mirë me administratën dhe një angazhim më I madh për ekzekutivin që të përgatisë në kohë raportet dhe informacionet e planifikuara në planin e aktiviteteve të këshillit por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar bashkëpunëtorët që asistojnënë aktivitetin e Këshillit të Bashksië Pogradec, projektin "Bashki të Forta", ftojmë të gjithë të bëhen pjesë për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sygjerimeve tuaja.

Punë të mbarë dhe faleminderit.

**Sekretare e Këshillit**

**Jona BOJKO**

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

M. Kamoli: Vazhdojmë në vazhdën e peticionit të cilin e kemi biseduar, kemi thirrur në takim prindërit, drejtoreshat e dy kopshteve dhe një sekretare..

Jona ka përgatitur një përmbledhje të procesverbalit të konsultimit me prindërit e fëmijëve të cilët kishin bërë peticionin.

Dua ta shtroj për diskutim, sepse akoma nuk kemi marrë një vendim përfundimtar, nëse do ta rrëzojmë vendimin nr. 84, dt. 18.08.2023 apo do të ndryshojmë ose shtojmë diçka.

S. Hexhilloli: Ne kemi një vendim të marrë në muajin gusht të 2023, ku kemi vendosur që prindërit të paguajnë një kuotë fikse, duke u nisur nga kërkesat e larta për tu regjistruar dhe fëmijve që duan të shkojnë çdo ditë të mos u'a zërë vendin një fëmijë që shkon sa herë që i teket.

Nëqo dalin këto pretendime nga prindërit, atëherë të vendosim një klauzolë për një fëmijë që mungon 5 (pesë) ditë rresht të mos paguaj kuotën ushqimore, duke pasur arsye shëndetësore ose familjare.

A. Gjoshe: Unë jam dakort që fëmija të mos paguaj kur mungon 5 ditë rresht dhe në muajit e verës të bëhet kuota ditore.

Biba: Kjo gjë duhet rregulluar, sepse ka pasur problem, kur fëmija mungon mos të llogaritet për ushqim, sepse listëprezenca merret në mëngjes.

S. Boldé: Këto pyetje ja bëra unë drejtoreshës, por më thanë që forca për ushqim merret prezenca e një dite më parë, që më tepër për kopshtin është: hapur në mëngjes deri në orën 9 (nëntë) dhe mëngjesin fëmijët e konsumojnë në orën 10 (dhjetë).

L. Seitllari: kjo tregon që ka vend për përmirësim.
Unë e kam votuar, pse vetët nga pesë për mua ofrohen.

Beka: Unë mendoj që prindërit kanë pasur të paingranuar, nëpërse regjistrimet bëhen në qershor, ndërsa ne e kemi marrë vendimin në muajin gusht.

Tani të shtojmë një klauzolë, kur të përmendim faktin kur një fëmijë mungon (para) dite, me arsye të justifikueshme, jo vetëm me raport, të mos paguaj.

F. Pikeli: Unë do të doja të lexonim edhe njëherë relacionin e vendimit që kemi marrë.

M. Kamolli: lexon relacionin e vendimit 84 dt. 28.08.2023.

M. Kamolli: Ajo më kap që fëmijët janë regjistruar në muajin qershor, ndërsa ne e kemi marrë vendimin në gusht.

F. Pikeli: Administrata i ka reaguar shkurt.

K. Tope: Ky vendim ka vend për përmirësim, ndoshta duhet të shtojmë një klauzolë.
~~[illegible]~~ Çdo vit pas viti bëhet një raportim mbi çmimet. Prindërit janë dakort të rriten çmimet, por jo të paguajnë kur nuk janë.

E. Shyti: Prindërit duhet të firmosnin një kontratë para fillimit. ~~[illegible]~~ Duhet që prindërit të kishin firmosur kontratën dhe tani nuk do kishin probleme.

E. Tureshinka: ka prindër që nuk kanë paguar akoma kuotën e muajit nëntor.

Marjo: kjo ndodh sepse prindërit janë neglizhent dhe paguajnë disa muaj bashkë.

M. Kamolli: Atëherë unë pres mendimet tuaja në grupin e tanë dhe mbledhjen tjetër të vendosim.

M. Kamolli: Vazhdojmë me një kërkesë nga banorët e ish-hotel

Guri i Kuq. Kemi një zonjë që do flasë

Shqipere Oparaku.

Ne kemi bërë shumë kërkesa për të privatizuar banesat tona,

por asnjë përgjigje pozitive nuk kemi marrë

M. Kamolli: Ka një znj. ligjore këtu.

A. Kanina: Që në vitin 2019 Kryetari ka bërë përpjekje për

të bërë të mundur privatizimin e këtyre banesave. Tani jemi

në fazën që po presim daljen e vendimit nga këshilli i

ministrave që një ndërtesë të kalojë në pronësi të

bashkisë dhe pastaj bashkia tina kalojë juve.

Shqipere Oparaku: Po derisa të dalë vendimi pallati do

shembet.

M. Kamolli: Po kaluar këto hapa që u thanë nuk

bëhet i mundur privatizimi nga ana juaj.

Ç. Hoxhilleri: Ne përsëri do t'ia çojmë shqetësimin kryetarit.

M. Kamolli: Kemi një pyetje. Jovan Vangjeli

Jovan Vangjeli: Unë kam një problem me rrugën për të

shkuar në shtëpi.

Më kanë bllokuar hyrjen për të shkuar në shtëpi.

Personi me të cilin kam probleme është vëllai im.

Unë kam trokitur në çdo derë dhe nuk më është dhënë

zgjidhje.

M. Kamolli: Ne do të mbajmë shënim ankesën tuaj

por nuk është çështje e këshillit.

Ju falenderoj për kohën tuaj!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Protokolli: Matilda Tollaku